

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 133 Prot.

Tiranë, më 30.01/2017

VENDIM Nr. 18, datë 24.01.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1 të datës 24.01.2017, pasi shqyrtoi *Raportin e gërmimit të Traktit të Rrugës në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit - TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Zemblak, KM 22+ 000, KM 23+700, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë *Raportin e gërmimit të Traktit të Rrugës në korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit - TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)* në zonën e Zemblak, KM 22+ 000, KM 23+700, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Shoqëria e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., të marrë masat për konservimin dhe ruajtjen *in situ*, të Traktit të Rrugës së zbuluar në zonën e Zemblak, KM 22+ 000, KM 23+700 dhe rehabilitimin e zonës.
3. Të kryhet devijimi i Linjës së tubacionit të Gazsjellësit TAP drejt perëndimit, jashtë kufirit të Traktit të Rrugës e cila do të ruhet *in situ*, por brenda kufive të parashikuar (RoW), në pjesën e trasesë të Traktit të Rrugës, e cila ishte dëmtuar më parë.
4. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazsjellësit TAP, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 99, datë 14.09.2016, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Dytë, KM 0 - KM 69".



5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO